



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 26 datë 4.4.2023

**“PËR DHËNIEN NË PËRDORIM PA KUNDERSHPERBLIM, MINISTRISË SE
MBROJTJES TË NJE SIPERFAQE PREJ 127 M2 NË PRONESI TË BASHKISË
SHKODËR”**

Keshilli Bashkiak Shkoder, në mbledhjen e tij të datës 4.4.2023, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të ligji nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen Vendore“ i ndryshuar; neni 6, 9 pika 1.2 ; 1.6 pika "a" dhe neni 54 "e"/1; Ligjit 7850 date 29.07.1994 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë i ndryshuar, neni 901 e vijues, për huapërdorjen; VKM Nr.421, datë 02.06.2010 “Për miratimin e listës Përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Shkodër, të Qarkut të Shkodrës, i ndryshuar, Çertifikatë për vërtetim pronësie Nr. 066039 date 14.12.2010 dhe Nr.Pasurie 5/311+1-6,ndodhur në ZK 8594.

V E N D O S I:

1. Miratimin për dhënie në përdorim pa kundërshtim të objektit *“Magazinë e Ish Hotel Sportit”*, me sip 127 m2, sipas planimetrise bashkelidhur.
2. Qellimi i përdorimit të këtij ambienti do të jetë ambjent për rekrutimin e kandidatëve për ushtarë /detar aktiv , por edhe ato rezervistët në Forcat e Armatosura.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimit të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

K R Y E T A R

Brisela KADIJA

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Denis Lesha

Miratuar me 27 vota

Vota Pro 27

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 11.4.2023